



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 850/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazic kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Selvije Kurti – Të Pavarurit e Mitrovicës dega në Mitrovicë, kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), dega në Mitrovicë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 13.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e pa afatshme ankesa e Selvije Kurtit – Të Pavarurit e Mitrovicës dega në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë Selvije Kurti – Të Pavarurit e Mitrovicës dega në Mitrovicë me datë 12.11.2013, në ora 15:50 në të cilën ka pretenduar se, kandidatja për Asamble Komunale në Komunën e Mitrovicës ka votuar në Qendrën e Vendvotimit (QV), nr.1102x (Avdullah Shabani) në VV 02R, kjo votë i është dedikuar subjektit 110 dhe kandidatës nr.3 si dhe në të njëjtin VV, ka votuar e gjithë familja e saj, ndërsa sipas formularëve të KKZ-së në Mitrovicë nuk gjindet asnjë votë. Përveq kësaj, në këto vendvotime 1116b/03d; 1123/01d; 1129b/02d; 1129/07R mungon fleta e dytë e formularit në vendvotimin 1102x/16d formulari është i paplotësuar dhe në vendvotimin 1125/01d mungon komplet formulari. Me anë të kësaj ankese kërkohet nga PZAP-I që të shqyrtohet rasti bazuar në ligjin e LZP-së si dhe të shqyrtohen të gjitha këto parregullësi dhe të merren masat ligjore ndaj të gjithë komisionerëve të këtyre vendvotimeve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pa afatshme

PZAP-i pasi shqyrtoi ankesën konstatoi se, ankesa është e pa afatshme pasi që, nga shkelja e supozuar ankesa nuk është dorëzuar në afatin e rregullt ligjorë deri më datë 04.11.2013 në ora 19:00, e njëjta është dorëzuar me dt. 12.11.2013 në ora 15:50 që nënkupton se është dorëzuar pas afatit andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 850/2013 më datën 13.11.2013.

Kryesuesi i Panelit

Nenad Lazic



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i..